

KUMTE PËR RAPORTET E KANUNIT ME LIGJIN

*Në fokus: drama klasiko-moderne
"Loja e mbasdrekës" e Martin Camajt*

Vepra dramatike që përcjell mesazhe me art të nivelit të epërm për ngritjen shpirtërore dhe përsosjen e njeriut, shoqërisë dhe vetë drejtësisë, ku dashuria mund urrejtjen, paqja luftën, e mira të triumfojë mbi të keqen, është vepër me vlera të larta. Prej kësaj semantike mund të formulohet mendimi se *letërsia dhe arti i vërtetë natyral*, jo vetëm janë *letërsi dhe art etern*, por edhe *opozitë e vërtetë për të çliruar njeriun nga vetvetja dhe shoqërinë nga çdo pushtim që shtyp, dhunon, frenon progresin e, në të njëjtën kohë janë thirrje për një botë dhe njeri më të mirë, më të përparuar dhe të qytetëruar. Të tilla janë kumtet e dramës "Loja e mbasdrekës" e Martin Camajt, në fokus të së cilës janë raportet e Kanunit me Ligjin. Para se të jap gjykimin tim kritik se si artistikja dhe estetikja dimensionojnë dhe fuqizojnë mesazhet e saj të shumta dhe të rëndësishme, sidomos për shtetin ligjor, mendoj ta njoh lexuesin me "Shënime mbi landën e dramës" prej autorit, i cili, me një faqe tekst, e fut lexuesin në atmosferën e tmerrshme të shekullit të kaluar për gjithçka ndodhi te Përroi i Mbyllë, përmbi Drin.*

"Ngjarja e kësaj drame, - shkruan Camaj, - mbështetet tërthorazi në një sezonë gjakmarrje të pa shembullt gjithkund ku shtrihej dikur pushteti i Kanunit të Lekës. Tregohet se në shekullin e kaluem, përmbi Drin, përpara se ky lum then qafën, vdiç një malësor. Ai e kishte lanë me fjalë që t'i baheshin drekët mortore ma të mëdhatë që mund të ishin. Malësori kishte arsyetue kështu: po vdes pa lanë djalë në votër. Mbasi për së gjalli nuk kam qenë as trim, as i pasun, së paku në vdekje, gjindja të flasin për mue. Duhet të më marrin nëpër gojë për një ditë, kishte thanë ai, si me pasë krye unë kushedi çfarë punësh në shej. E la me gojë, në drekët mortore të tij, të qitet raki e mirë rrushi që rritet kokërr vogël, por i ambël, ndër bria të rreshkuna prej diellit, përball Drinit. Burri i malësisë, pra lypte edhe këtë përjashtim, **ndoshta me paramendim të keq!** Ndër drekët e malësorit erdhi i thirrur e i pa thirrur. Ndodhi që u gjetën ballë për ballë në këtë vis të Kanunit të Lekës **gjaks dhe gjakmarrës**. Edhe sikur të ishin ndeshë në ndonji vend tjetër e, jo, si të grishun në mort, do të

*kishte plas, aty për aty, arma e zjarrmit. Të grishunit hangrën e pinë, tue kuvendue shemri me shemër, mbasi kështu e lypte burrnia kanunore! Kah mbarimi, ngjau, që **plasi** **nji pushkë**, ndoshta edhe pa hiri. Pa pyet se çka qe, secili, - i nxemë edhe prej pije, lëshohet në armë dhe shtie në anmik, dikush për të marrë gjakun, nji tjetër për t'u mbrojtë. Për afër dhjetë minutash, u vranë aty, pa luejt vendi, njëzet e katër vetë, vdekë e plagosë. **Pesëdhjetë vjet ma vonë**, po në këtë trevë ku kish ndodhë kjo zezonë, përpiqen vetjet e kësaj drame "Loja e mbasadrekës" të gjejnë shkaqet kryesore të rrëshkatës dhe **atë njeri** që ka nis grindjen ma të përgjakshme në historin e atij visi, përmbi se then Drini Qafën". ("Loja e mbasadrekës". Apolonia. Tiranë, fq. 9,1996)*

Që në krye të herës, theksoj se nga kjo dramë burojnë mesazhe të rëndësishme dhe të fuqishme që i *flasin indirekt kohës sonë* në raportet e Kanunit me Ligjin, si për degjenerimin dhe abuzimet me kanunin, ashtu edhe me zvetënimin apo heshtjen e shtetit ligjor e, për këtë shkak, agresiviteti i Kanunit bëhet më i egër. Dramaturgu Camaj me vizion të qartë, inteligjencie të rrallë dhe profesionalizëm, ka shestuar dhe formësuar mjeshtërisht veprën e tij, si një dramë klasiko-moderne dhe psikologjike *ngritur mbi një tezë*, me *prolog* dhe *epilog*, me dy pjesë, e para me shtatë *duka* dhe e dyta me katër *duka*. Është konceptuar si *një lojë teatrore mbi një tragjedi njerëzore*. Sikur-i skenik, magjik, si mjet shprehës shumëdimensional dhe inkandeshent, është sa klasik aq dhe modern.

Ngjarja tragjike ka sugjeruar vështrimin psikanalitik të personazheve të dramës, sidomos të shkaktarit të tragjedisë në zezonën e Përroit të Mbyllë, po edhe të të gjithë procesit gjyqësor, çka *jepet në kompleks kriza e Kanunit dhe Ligjit të shtetit*, duke stigmatizuar të keqen. Publiku merr **kumtin** se nga kuptimësitë e së keqes të nxjerrim kuptimësitë e së mirës.

I gjithë arsenali i mjeteve dramaturgjike që ka aplikuar Camaj në këtë dramë, promovon profesionalizmin e tij të lartë. Shquhet stili i i nivelit të epërm të autorit, ekspresiviteti i dialogut, dinamika e tij e brendshme, gjuha me kolor dhe nënteksti që flet më shumë se teksti. Nëpërmjet dialogimit Zeka-Bjeshka, në prolog, shfaqen momente e detaje substanciale që nxisin fantazinë e lexuesit apo të publikut të sallës së shfaqjes, i cili ndien me kërshtëri atë që paraqitet si enigmë, e gradualisht shpaloset gjatë procesit të zhvillimit dramaturgjik të dramës, duke e ruajtur enigmatitetin. Me mjeshtëri janë integruar elemente të dramës klasike me atë moderne dhe mjete të mrekullueshme artistike të dramatikës, në funksion të mendimit dhe mesazhit prej të

cilit lexuesi merr kënaqësi të vërtetë estetike.

Ja disa pjesëza nga dialogu Zeka- Bjeshka (fq. 8-11) Z e k a: “Këpute kallëzimin e nis e n e m anmiqtë që po ma lanë mue fajin për këtë rrëshkatë. Vajto, jo me fjalë rresht e rresht, thjeshtë si tue kuvend! Gjysëm vajtim e gjysëm kallëzim”. B j e sh k a: “Qe, u mbushën pesëdhjetë vjet, or burrë, qysh se u vranë njëzet e katër vetë, gju më gju e gisht për gisht. Ashtë kalbë nën dhe, deri gjuha e grave që vajtuen mbarë e mbrapsht, fort dhimbshëm, mbi trupat e të vdekunve. Harroji, bre burrë, harroji sadopak, vetë Zoti ka dasht që shpëtove atëherë...”. Z e k a: “Lene vajtimin e kallëzimin po të them e nis n e m ë n kundër a t i j që më tha v ë l l a, pa më pyët dhe, në të parin rast te Përroi i Mbyllë ma solli armën pa ditur kurrë për çka edhe mbas pesëmbëdhjetë vjetësh”. B j e sh k a: “Ku t’ia filloj, unë e mjera, ashtë një gjysëm shekulli.....Atë mot i prenë pleqtë verrat brigjeve të Përroit të Mbyllë; me lëvoret e verrave nuset ngiyen zhguna të zez për tirq burrash e xhubleta grashë. Kush na çliron prej ngjyrës së zezë? Perëndia apo Ora e fisit?...” (Po, aty)

Ngjarja tragjike e kësaj drame psikologjike, do të zvirdeh nëse do të kishte rënë në dorë të një dramaturgu jo të nivelit të Camaj, i cili, si artist i fjalës, gjuhës skenike dhe dialogut, ka krijuar një tekst me shtresa ë nënshtresa polisemantike duke zhbiruar në ndërgjegjen e personazheve që përjetojnë dhe shfaqin dramatrikisht krizën e dokeve të kanunit dhe të ligjit të shtetit. Autori ka vënë thekse dominante në ekspozimin e dukurive negative dhe stigmatizimin e tyre me ironi e satirë, me të cilat përshkohet tërë drama “Loja e mbasdrekës”.

Krisja e tabusë së Kanunit

Gjakës dhe gjakësorë në drekën mortore pinë raki dhe hanë mish të pjekur, **kur kanuni e ndalonte!** Ndonëse ishte amaneti i të vdekurit, doku i kanunit shkelet. Këtu kemi krisjen e parë të kanunit që shpalos drama. Mesazhi është i qartë: *Kanuni është i kontestueshëm*. Kjo nuk ka të bëjë me mohimin e vlerave të Kanunit kur nuk ekzistonte ligji i shtetit. Autori ka një koncept të drejtë për këtë. Ai e njeh mirë Kanunin e Lekës, në viset ku aplikohet, si rregullator i jetës, krejt i domosdoshëm për kohën kur mungonte shteti. E njeh mirë si në rrafshin teorik, ashtu edhe zbatimin në praktikë; njeh rolin pozitiv të tij në gjykimet për dhënien e drejtësisë në konflikte, ngjarje tragjike, vrasje apo zezonë, në çdo rrafsh të jetës; por, në të njëjtën kohë, njeh edhe *mitin* e tij, i cili erdhi gjithnjë duke u rritur e bërë i besueshëm verbërisht sa u shndërrua në *tabu*. Njeh edhe abuzimet me Kanunin, shtrembërimet dhe degjenerimin që i bëhej. Pikërisht në darkën mortore nis çmitizimi i tij, - njëfarë rebelimi.

Dikush edhe e refuzoi pirjen e rakisë, ndërsa opinioni i masës iu kundërvu me “amanetin” e të vdekurit. Dikush thoshte se sipas Kanunit nuk refuzohet, disa të tjerëve ua kishte ënda të pinin raki, pa e vrarë mendjen. Kështu *vetë masa, në këtë rast, po redakton dhe shpërfill Kanunin*. Ky këndvështrim i autorit si qasje për çmitizimin e mitit të Kanunit, përshkon tërë këtë vepër, si në lojën teatrore në gjyqin virtual, ashtu edhe në skenat realiste në Pjesën e parë, kur Gjormi, i nisur nga një ngjarje konkrete historike, do të takonte Zekën për të zbuluar shkaktarin e zezonës të Përroi i Mbyllë dhe, të njihet konkretisht me thelbin e Kanunit dhe me degjenerimin e disa dokeve të tij, për të realizuar temën e diplomës si kandidat për jurist.

Degjenerimi i Kanunit çon në zezonë

Studenti për jurist, Gjormi, që është edhe protagonist i dramës, merr përsipër të vërtetojë këtë, sipas këtij formulimi: *“Superstruktura e vjetër ligjore, në kundërshtim me rendin e ri, apo zvetënimin vetëm i pjesëshëm i Kanunit nga ligji ndërkombëtar, kushtëzuen zvetënimin e njerit apo tjetrit ligj”*. (fq. 50) Një konceptim i tillë është i jashtëzakonshëm, kërkon çuditoren, mbrekulloren dhe fantastiken që realitetin historik jetësor ta rikrijosh më të përsosur, çka Martin Camaj e ka arritur në “Loja e mbasdrekes”. Falë talentit të tij si dramaturg, ka shëstuar, formësuar dhe strukturuar dramën, duke vendosur në qendër të saj tezën e Gjormit si bosht artistik që ndërlihd ngjarjet, episodet, dramën e personazhit kryesor Zekës, me të gjithë personazhet e veprës, sidomos me ato të lojës teatrore që përbëjnë trupin gjyqësor, duke krijuar një unitet ideoartistik, me synim: të shprehen fuqishëm mesazhet për shërimin e kësaj plage e cila sa herë ngacmohet, agravohet dhe shpërthen duke krijuar zezona të reja. Shpalosja dramatike dhe substanciale e tërë përmbajtjes së tezës së Gjormit për realitetin e gjakmarrjes dhe veprimin e ligjit e të kanunit njëherësh, me sensin realist, por edhe kritik e stigmatizues, përcjell indirekt kumte edhe për kohën tonë: *nëse ligji hesht apo zvjorrdhet, atëherë vepron Kanuni. Nëse veprojnë të dy në një kohë, krijohet kaos. Krijohet terren për abuzime dhe degjenerim*. Në dramë, këtë e dallojmë në tri linja: në atë të veprimtarisë së Gjormit, ku në gjyqin-lojë të dramës luan rolin e Avokatit; në linjën e Mjekut të Prushit që lot Prokurorin, në linjën e Gjyqtarit dhe atë Zekës, që mbeti gjallë nga zezona e Përroit të Mbyllë dhe, pas një gjysmëshekulli, akuzohet si shkaktar i rrëshkatës.

Veprime të njëkohshme të ligjit të shtetit dhe të Kanunit, shfaqen herë të dukshme, herë të padukshme si te Prokurori, Avokati, e më pak

te Gjyqtari, ku në qendër është Zeka, i cili i fshihet edhe kanunit edhe ligjit. Kanuni nuk arriti ta gjykojë për pesëdhjetë vjet. Nga tmerrri i zbulimit futet në udhën e krimeve të reja, duke vrarë ata që dyshon se mund ta vrasin. Para se të më vrasësh ti mua, mendon ai, po të vras unë ty. Nga një anë, doket e gjakmarrjes i jepnin mbështetje për të vrarë, nga ana tjetër, e ndiqnin pas e, ai, plot ankth dhe tmerr, i rraskapitur shpirtërisht e fizikisht, fshihej, herë si lypsar, herë nëpër male, me peshën e krimit dhe të ankthit mbi shpinë dhe në shpirt. Po në të njëjtën kohë, edhe ligji po e ndiqte hap pas hapi për të zbuluar fajësinë apo pafajësinë e tij. Në një situatë, gjatë lojës dramatike, Zeka pohon: *“Tash pesëdhjetë vjet, çdo herë që bie fjala për zezonën e Përronit të Mbyllë, ka njerëz që thonë se unë paskam qenë shkak i asaj gjakderdhje. Këtu kemi dy ligje, një të Maleve, don me thanë, Kanunin e Lekës, e një të pushtetit, e paçim me jetë!”* (fq. 41)

Zeka kaq shumë është torturuar shpirtërisht dhe psikologjikisht nga hija e Kanunit, për pesëdhjetë vjet, sa do të gjykohet prej ligjit, duke e konsideruar atë më të butë. Mirëpo edhe M j e k u që loz rolin e prokurorit, psikologjikisht është nën tryshninë e Kanunit, në një aspekt tjetër. Kur nis procesi gjyqësor, ai betohet sipas dokeve kanunore: *“Në gjykofsha me të padrejtë (merr gurin e pendesës në duar) e paça këtë peshë në krah, në këtë jetë e në atë jetë!”* (fq. 60) Gj y q t a r i menjëherë shpreh një revoltë të përmbajtur: *“Këtu po përziem ligje shtetnore, bashkë me praktika të Kanunit! Dreqi s’e merr vesh!”* (fq. 60) Ndërsa Z e k a, duke ndier rëndshëm tryshninë e Kanunit dhe të ligjit, duke iu fshetur njërit dhe tjetrit, kur Gjyqtari e pyet: *“Zekë, simbas cilit ligj don me qenë i gjykuem?”*, i përgjigjet: *“Simbas ligjit të ri, or tugjatjeta, por mos me më pleqnue mbrapsht, ashtu siç nuk asht pleqnue askush deri më sot... Do të pranoja ma mirë vdekjen se cilësimin fajtor...”* (fq. 48) Siç shihet, autori me art të klasit të parë ka krijuar realitetin artistik, më të lartë se jeta, siç thoshte Didëro.

* * *

Në pjesën e parë, me mjeshtëri jepen elemente të portretit të personazheve: Zekës, Gjormit, Bjeshkës, Jonjës, Mjekut të Prushit; ravijëzimet e para të individualitetit të tyre si personazhe psikologjike; është dhënë bukur atmosfera e realitetit të kohës ku ekspozohet zezona gjakmarrëse dhe përkushtimi ndaj ligjit për të zbuluar të vërtetën dhe për të dënuar shkaktarin e rrëshkatës. Ndërsa në Pjesën e dytë, në gjyqin e Zekës shpërfaqet Kanuni dhe Ligji në krizë, sipas tezës së Gjormit. Personazhet shpirtëzohen e formësohen si figura të plota e komplekse. Këtu dramaciteti është më i madh, arti në nivelet e epërme dhe mesazhet janë jo vetëm të shumta e të larmishme, por disa prej të tyre burojnë

edhe nga dialogët dhe debatet e personazheve. *Qasja psikologjike dhe psikanalitike e autorit në zhbirimin e botës së brendshme të personazheve dhe të dukurive të vjetra e të reja për të zbuluar të vërtetën e degjenerimit të Kanunit, kanë krijuar hapësira dhe mundësi të pafundme sa, ndonëse para drejtësisë del Zeka, aty gjykohet jo vetëm ai, por Kanuni dhe ligji i shtetit. Gjormi, si student i juridikut dhe avokat i Zekës, dhe Mjeku i Prushit, si prokuror i Zekës, me detajet, veprimet, dialogët dhe debatet në gjyq zbulojnë vetveten, duke aplikuar edhe kanunin, edhe ligjin. Ndërsa Gjyqtari, ndonëse është më shumë i qartë, ka dhe momente të turbullta.*

Që në fillim të dramës, Gjormi, nëpërmjet sentencës: *“Unë dëshiroj të zbuloj rranjët e së keqes, për t’u çelë sytë të gjithëve se gjakmarrja ashtë plagë, zezonë e përjetëshme”* (fq. 21), përcjell mesazhin e gjyqtarit të ri, si thirrje për ligjin i ri, për t’i shkuar deri në fund zbulimit të së vërtetës. Ai thotë: *“Humba të parin proces në jetën time, po unë këtë punë nuk do ta lë me kaq...”* (fq. 67) Z e k a: *“Ku do me dalë?! .. Me i ndalë hovin gjakut?... (Qesh... duke u sjellë me krye kah muri, mblidhet galiç, sikur priste të vijë dikush ta fusë në thes) (fq. 67).*

* * *

Kam theksuar më shumë se një herë: kumtet e kësaj drame janë të pafundme, që burojnë më shumë nga nënshtresat sesa nga shtresat e tekstit. Tek të rëndësishmet, është edhe falja e gjakut.

Falja e gjakut - fisnikëri dhe qytetërim

Mjekut të Prushit, që luan edhe rolin e prokurorit, Zeka i ka vrarë gjyshin dhe Gjormit-avokat të jatin, siç argumentohet në procesin gjyqësor, në lojën teatrale. Mirëpo as Mjeku, as Gjormi nuk shfaqin elemente të urrejtjes, hakmarrjes, as të gjakmarrjes. Gjormi e thotë haptas se ia ka falur gjakun, po edhe Mjeku, në mënyrën e tij, këtë pohon. Dukuria e faljes së gjakut në këtë dramë zë një vend të dorës së dytë, çka shpjegohet me faktin se në realitetin kur zhvillohen ngjarjet, ky fenomen ishte i rrallë. Mirëpo pesha ideo-emocionale e këtij akti, pikërisht nga ata që kanë në dorë gjykimin e personit që ka për të marrë gjak dhe ia falin atë, është e madhe, me forcë ndikuese e vepruese te lexuesit ose spektatorët. Këtu lind pyetja: Nga ç’ motive u nisën këta dy personazhe? Në konceptin tim, falja e gjakut apo zgjidhja e konflikteve të përmasave të mëdha, mund të bëhet nga njerëz të emancipuar, të ditur, me kulturë, nga ata që kanë moral të lartë, që janë humanë, që mendojnë dhe arsyetojnë se zgjidhja e konflikteve me vetëgjyqësi sjell vdekje pas vdekjesh, ndërsa toleranca, mirëkuptimi dhe zhvlerësimi i

strukturave të vjetruara kanunore, vënë në lëvizje mekanizmat e ringjalljes së dashurisë njerëzore, që të çon te pajtimi, paqja.

Mjeku dhe Gjormi, në raport me malësorët, ishin më të ditur, më të emancipuar dhe më humanë: njëri ishte mjek, detyra e të cilit ishte shërimi i njeriut, ndërsa tjetri avokat që merrte përsipër mbrojtjen e njeriut. Që të dy, pra, kishin objekt mbrojtjen e njeriut, njëri ta shëronte nga sëmundjet, tjetri ta mbronte duke dhënë drejtësi, edhe kur e dënonte, nëse vërtetohej krimi. *Nga ky trajtim që bën dramaturgu në rrafshin e sikur-it magjik në lojës teatrore, buron mesazhi i braktisjes së gjakmarrjes si një atavizëm i kohërave tragjike të egërsisë primitive, duke u hedhur në luftë për çlirimin e vetvetes nga ky pushtim fatal dhe nga opinioni kolektiv prej shpellarëve.*

Si intelektual, ata e kuptonin dhe e ndienin më shumë se të paditurit dhe sidomos fanatikët se ç' tragjedi njerëzore sillnin disa prej dokeve kanunore, duke u trashëguar nga brezi në brez. Ndaj Gjormi as që donte të dinte për gjakun që kishte për të marrë te Zeka, ndërsa Mjeku nuk u shfaq në fillim si dëshmitar okular i zezonës së Përronit të Myllë, sepse atëherë do të detyrohej të vriste Zekën. Për sa i përket detyrës si prokuror në lojën teatrore, ai e akuzonte Zekën për krimet në zezonë dhe pas saj, duke e përballë me ligjet e shtetit, sepse e keqja duhet dënuar.

Mirëpo shumica e malësorëve nuk mendonin si Mjeku i Pushit. Zekës i kishin ngritur këngë. Autori i sheh në kompleksitetin e tyre dukuritë, ashtu siç i përmbante realiteti i viseve ku sundonte Kanuni. Forca e dokeve gjakmarrëse të Kanunit ishte kaq e lartë, sa respektoheshin e vlerësoheshin maksimalisht nga masat duke i kënduar "trimërisë" së vrasësit. Kjo ishte e moralshme, e virtytshme për ta. Gjakmarrësi konsiderohej i zoti dhe i nderuar. Ndërsa ai që s'e merrte dot gjakun, quhej i poshtëruar, frikacak, atij dhe kafen ia jepnin jo si të tjerëve, por nën gju. Ky moral i tjetërsuar, ku krimineli vishej me rrobën e heroit, padyshim, ishte sa egërsi primitive, aq dhe absurde.

"Loja e mbasdrekës" pikërisht kundër këtij morali i drejton shigjetat e kritikës. Gjyqtari thotë: "Problemi ashtë për të çrranjës në thelb doket e vjetra... Po këto doke kush i mba në kambë?... Burrat si Zeka!". (fq. 72) Siç kuptohet prej këtij teksti, qëndrimi ideoemocional kritikues mbahet jo ndaj viktimave të dokeve të shëmtuara, por ndaj bartësve të tyre, në emër të të cilave, burrat si Zeka kryenin akte kriminale. Duke dënuar doket e këqija të kohës, drama jo vetëm jep mesazhe për çmitizimin e Kanunit, por edhe për krijimin e një morali të lartë, duke sfiduar antimoralin, ku i thuren lavde së keqes të kanonizuar, duke u

mbështetur nga opinioni i masës që ishte shndërruar në turmë të verbër, skllave e kanunit.

Roli i masës në dramën e Camajt

Në mjedisin artistik të dramës, përtej sheshit skenik, prapa një gardhi qëndron masa. Gjatë veprimit dramatik në procesin gjyqësor, ajo përkrah dhe mbështet Kanunin duke kundërshtuar ligjin e shtetit, si në rastin kur Zeka thotë: *“Kur mundet, kush rri pa e marrë gjakun?... Doli dikush e vrau Gjyqtarin, a nuk kish me ia marrë gjakun qeveria që e ka çue këtu?!...”* Dhe kur Gjyqtari i thotë: *“Shteti nuk hakmerret”*, grupi i malësorëve prapa gardhit, lëviz, kundërshton, zhurmëron, bërtet. Atëherë, ai, me ton të rëndë, kritik e shpotitës thotë: *“Ata ende nuk e njohin, jo ma ta pranojnë ligjin e shtetit”*. (fq. 45) E kjo, mjerisht, është e pranishme edhe sot në shoqërinë tonë, e bartur nga ata që nuk janë çliruar nga prangat e gjakmarrjes. Ndërsa në një situatë tjetër, kur Gjormi deklaron: *“Askush nuk e ka ndalë Mjekun të bajë një trimni, të dalë e të thotë, nuk due shpagim e të ndjek doket e shëmtuara të tjera kohëve”* (fq. 45), në grupin e njerëzve përreth përsëri ka kundërshtime, një lloj revolte që shprehet me zhurmë, lëvizje e gjeste. Ata nuk pranojnë heqjen dorë nga doket gjakmarrëse të Kanunit, edhe kur janë të tejkaluara. *Për ata, Kanuni është i shenjtë, i pakontestueshëm.* Kjo psikologji ishte bërë pjesë e ndërjegjes së tyre, pjesë e një morali të shëmtuar. Ai që nuk i zbaton ato, është i padenjë, frikacak, i pazoti, njeri që mbulohet me turp dhe me përbuzjen e shumicës.

Kundër kësaj psikologjie dhe opinioni ngrihet autori në këtë dramë duke përcjellë mesazhin e sfidimit dhe të çmitizimit të zakoneve të vjetra regresive, opinioneve të verbëta dhe dokeve të shëmtuara, të cilat sjellin zezona dhe e mbajnë shoqërinë brenda rrahtëve hermetikë të sistemeve të mbyllura, që sfidojnë filozofinë e ndryshimeve progresiste. Nga nënshtresat semantike buron kumti: *ligji dhe vetëm ligji* është alternativa që mund dhe duhet ta ndalë murtajën e gjakmarrjes. Dhuna e ligjit duhet të bjerë e rreptë si mbi ata që aplikojnë gjakmarrjen, ashtu edhe mbi ata që shtrembërojnë kanunin dhe abuzojnë me të, apo me të tjerë që, në emër të pajtimit e faljes së gjakut, bëjnë tregti të ndyrë.

Semantika e rënies së pikës - ZEKËS

Gjatë pesëdhjetëvjetëshit pas aktit kriminal të zezonës, Zeka jeton në ankthin e trysnisë së krimeve, i cili e shtyn atë në krime të reja për të mbuluar të vjetrat, siç theksova më lart. Kjo e detyron të bëjë një jetë endacake prej lypësi, të fshihej ku të mundte, të mos binte në kontakt me njerëzit që dinin të vërtetën e mund ta vrisnin, apo me ata që

dyshonin, por edhe me njerëzit e ligjit të shtetit që e kërkonin. Zeka i lodhur mendërisht, i rraskapitur fizikisht, i traumatizuar psikologjikisht dhe moralisht kishte nisur të ndiente urrejtje për kanunin, po dhe për ligjin e ri që kërkon ta gjykonte. Megjithatë, midis dy të këqijave zgjodhi të keqen më të vogël, duke menduar se ligji duhet të jetë më i butë. Po nëse ligji do ta nxirrte fajtor, ai nuk do ta pranonte, deklaroi para trupit gjykues, sepse do të ngriheshin ata që kishin për të marrë gjak e do ta vrisnin. Kuptimi i ekzistencës për të s'do të kishte kuptim, do të mbaronte gjithçka.

Në fund të procesit, kur Gjyqtari i thotë: *“Zekë. A pranon se je shkaktar i kërdisë së Përroit të Mbyll?!... E pranon apo jo!... Po, ç'randësi ka. Në emër të ligjit unë të dënoj”*. Kjo e goditi në tru, gjakësorët iu shfaqën si hije. *As te ligji i shteti nuk gjeti shpëtim*. Në sallën e gjyqit mblidhet sa një gogël, spërdridhet ... dhe bie përtokë. *Plasi në lëkurë të vet siç thotë populli. I ra pika!... Vdiç!*

Mesazhi që del prej këtij fundi dramatiko-tragjik të Zekës, si protagonist i dramës, në formulimin tim do të ishte: *Për ata që kanë gjak për të marrë, a për cilindo që konfliktet e vogla apo të mëdha i zgjidh me vetëgjyqësi, herët a vonë, edhe pas një gjysmëshekulli, ndëshkimi i ligjit do të bjerë mbi ta, madje edhe në format më të ndryshme duke u rënë pika, si Zekës. Po mesazhi më i rëndësishëm, i fshehur në nënshtresa kuptimore, që i përcillet shoqërisë së sotme, është: Çlirimi i njeriut prej vetvetes kanunore dhe prej dokeve të vjetra, të abuzimeve me Kanunin dhe me Ligjin, është alternativa më e mirë që të orienton në kahun e duhur, të kërkosh drejtësi nga ligji. Në të njëjtën kohë, edhe çlirimi i drejtësisë nga pushtimet e këqija, që të japë vetëm drejtësi duke ndëshkuar çdo krim e kriminel, kushdo qoftë ai, do të bënte të sfidohej alibia e drejtësisë që vret drejtësinë, siç thoshte Albert Kamy.*

Si përfundim: *“Loja e mbasdrekës”* është një dramë klasiko-moderne, ndër më të fuqishmet e dramaturgjisë sonë kombëtare, e shkruar me kulturë, dije të thella, me gjuhë të bukur gegërishte, me stil të lartë dhe vizion prej intelektualit e dramaturgu të shquar, një dramë me mesazhe njerëzore dhe universale, e cila, duke iu referuar realitetit të djeshëm në rrafshin e gjakmarrjes, transmeton mesazhe inkandeshente për shoqërinë tonë në raportet Kanun-Ligj, sidomos në rrafshin e shtrembërimit të dokeve e abuzimit me to dhe të formave të tjera abuzive mafioze, kur ligji i shtetit zvetënohet apo hesht.

Gjyqtari i ri, Gjormi, do të jepte këtë mesazh: *“Për ju që lexoni këtë lojë, (apo ndiqni shfaqjen në teatër - M.P.), - një lutje: kur të mbeten vetëm,*

sonte ose nesër, as fjalët gjak, gjakderdhje, zezonë dhe urrejtje, të mos ju bien ndërmend! Lëshojini përfytyrimet e hidhta në ujë të rrëmbyeshëm!" ("Loja e masdrekës", Apollonia, Tiranë, fq.74, 1996)

Literatura e shfrytëzuar:

1. Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Kuvendi. Lezhë, 2001.
2. Elezi, Ismet dhe Zojsi, Rrok. *Kanuni i Labërisë*. Toena. Tiranë, 2006.
3. Pepo, Petraq. *Kanunorë të shoqërive shqiptare (1870-1836)*. Ada. Tiranë, 2007.
4. Kadare, Ismail. *Prilli i thyer*. Onufri. Tiranë, 2003.
5. Shehu, Rexhep. *Kush shëmton Malësinë me abuzimin e gjakmarrjes*. Tirana Observër, Tiranë, tetor 2011.
6. Koliqi, Ernest. *Kritika IV*. Rilindja, Prishtinë, 1976.
7. Konica, Faik. *Kritika IV*. Rilindja. Tiranë, 1972.
8. Rugova, Ibrahim. *Strategjia e kuptimit*. Faik Konica. Prishtinë, 2005.
9. Prençi, Mexhit. *Optikë alternative për dramën*. Logoreci. Tiranë, 2001.
10. Prençi, Mexhit. *Kritika 1*. Omska, Tiranë, 2008.
11. Vellek, R. dhe Uoren, O. *Teoria e letërsisë*. Prishtinë, 1985.